



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 533/5 Prot.

Tiranë, më 29/06/2015

V E N D I M

Nr. 32, datë 29/06/2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", të procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Duo Contact*" sh.p.k.

V Ë R E J S E :

Në zbatim të Urdhrit nr. 129 datë 01/06/2015, është kryer hetim administrativ pranë subjektit kontrollues "*Duo Contact*" sh.p.k, me objekt: Plotësimi i detyrimit për njoftim (neni 21 i Ligjit nr. 9887 dt. 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar).

Kontrolluesi, gjatë ushtrimit të aktivitetit, mbledh, përpunon dhe ruan të dhëna personale për subjektet e të dhënave të cilët kanë lidhje me aktivitetin e tij. Nga hetimi administrativ i ushtruar dhe provat e administruara pranë kontrolluesit, rezultoi se "*Duo Contact*" sh.p.k nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor për të njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit (neni 21).

Për shkeljen e konstatuar është mbajtur procesverbali i konstatimit në momentin e ushtrimit të Kontrollit Administrativ.

Mbas shkeljes së konstatuar nga grupi i hetimit administrativ, përfaqësuesi i kontrolluesit "*Duo Contact*" sh.p.k. ka paraqitur në procesverbal pretendimin se: "*Formularin e Njoftimit e ka nisur me postë në datën 21/04/2015 dhe me vete ka sjellë një kopje të formularit të dërguar më parë*".

Lidhur me pretendimin e përfaqësuesit të kontrolluesit se "*Formularin e Njoftimit e ka nisur me postë në datën 21/04/2015*", vlen të theksohet se ai nuk ka mundur të paraqesë prova për këtë fakt. Megjithëse përfaqësuesi i kontrolluesit nuk ka mundur të paraqesë prova, grupi i hetimit administrativ ka verifikuar protokollin e Institucionit të K.D.I.M.Dh.P. së dhe ka konstatuar se deri në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ në vend (në ambientin e kontrolluesit), nuk është dorëzuar formulari i njoftimit nga kontrolluesi "*Duo Contact*" sh.p.k.

Përfaqësuesi i kontrolluesit ka depozituar në protokollin e K.D.I.M.Dh.P. së "*Formularin e Njoftimit*", duke realizuar në këtë mënyrë detyrimin për njoftim, menjëherë mbas ushtrimit të hetimit administrativ dhe konstatimit të kësaj shkelje nga grupi i kontrollit.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar si dhe në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", me shkresën nr. 533/3 prot. dt. 17/06/2015 është njoftuar kontrolluesi "*Duo Contact*" sh.p.k për tu paraqitur pranë ambienteve të zyrës së Komisionerit më datë 29/06/2015 ora 12:00, për tu dëgjuar në lidhje me pretendimet e mundshme të tij.

Kontrolluesi "*Duo Contact*" sh.p.k është paraqitur në datën dhe orën e përcaktuar dhe njoftuar për seancën dëgjimore. Përfaqësuesi i kontrolluesit nuk ka paraqitur pretendime të tjera dhe është shprehur se: "*Nëse do të penalizohet me masë administrative, ajo të jetë në vlera sa më të ulëta*".

Nga verifikimi në regjistrin elektronik si dhe në protokollin e brendshëm të autoritetit "*Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", rezulton se kontrolluesi "*Duo Contact*" sh.p.k, ka plotësuar "*detyrimin për njoftim*" më datë 05/06/2015.

Sipas Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, kontrolluesit kanë përgjegjësinë për përpunimin e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, e për pasojë, detyrimin për zbatimin e të gjitha kërkesave të këtij ligji, në mënyrë të veçantë, atë që parashikon paragrafi 1 i nenit 21: "*...Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligj*".

Bazuar në nenin 25/1 të ligjit, kontrolluesi nuk mund të fillojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar më parë Zyrën e Komisionerit. Në këto kushte, konsiderohet shkelje serioze përpunimi i të dhënave personale, pa njoftuar dhe pa u regjistruar më parë, në Regjistrin Qëndror të subjekteve kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit.

Si përfundim, shkelja e konstatuar gjatë ushtrimit të kontrollit administrativ në kuptim të nenit 39/1 shkronja "d" të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, përbën "*kundërvajtje administrative*" dhe dënohet me gjobë.

Në caktimin e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysht faktin se shkelja e konstatuar është riparuar menjëherë, çka tregon ndërgjegjësimin e subjektit të kontrolluar për zbatimin e ligjit.

PËR KËTO ARSYE :

Në zbatim të neneve 21, 30, 31, 32/1, 39/1/d, 39/2, 40 dhe 41 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar,

V E N D O S A :

1. Dënimin e kontrolluesit "*Duo Contact*" sh.p.k me gjobë në vlerën 100.000 (njëqindmijë) lekë.

